



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2024:086203
Datë: 23.05.2024
Numri i dokumentit: 05726409

K.Dh.Shk II.nr.359/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtaren Franciska Zhitija Ymeri në çështjen përmbartimore të kreditorit “B & D ENGINEERING” SH.P.K., me NUI: 811470989, me seli në rr. “Lidhja e Pejës” nr.69, në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Arbër Shala., avokat nga Prishtina, kundër debitorit “Trepça” SH.A., me seli në rr. “Parku Industrial” në Mitrovicë, kundër debitorit Komuna e Podujevës, me seli në Podujevë, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit si dhe ankesën e debitorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.570/23 të datës 26.10.2023, me datë 23.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e kreditorit “B & D ENGINEERING” SH.P.K., dhe ankesa e debitorit “Trepça” SH.A., ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.570/23 të datës 26.10.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.570/23 të datës 26.10.2023, ka vendosur si në vijim: I. APROVOHET pjesërisht prapësimi i debitorit “Trepça” SH.A., dhe ANULOHET pjesërisht Urdhri për lejimin e përmbarimit P.nr.50/2023 i datës 24.03.2023, i lejuar nga Përmbaruesi Privat Atip Mustafa, për pjesën e kamatës ligjore prej 8% nga data 20.11.2022 e deri në pagesën definitive. II. REFUZOHET pjesërisht prapësimi i debitorit “Trepça” SH.A., dhe MBETET në fuqi pjesa tjetër e Urdhrit Përmbarimor P.nr.50/2023 të datës 24.03.2023, të Përmbaruesit Privat Driton Govori me të cilën është caktuar përmbarimi, për pjesën e detyrimit kryesor në shumën 19,906.60 €, (nëntëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e gjashtë euro e gjashtëdhjetë cent). PËRFUNDOHET pjesërisht procedura përmbarimore e kreditorit “B&D ENGINEERING” SH.P.K., ndaj debitorit “Trepça” SH.A., sipas Urdhrit Përmbarimor P.nr.50/2023 të datës 24.03.2023, për pjesën e kamatës ligjore prej 8% nga data 20.11.2022 e deri në pagesën definitive. IV. DETYROHET debitori që në emër të shpenzimeve për përpilimin e përgjigjes në prapësim t’ia paguaj kreditorit shumën prej 208.00 € (dyqind e tetë euro) në afat prej 7 (shtatë) ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës përmbarimore si dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Shkallës së Dytë, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të ndryshohet pika I dhe III e aktvendimit të Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, ashtu që të caktohet kamata ligjore prej 8% nga data 28.01.2023 si ditë e rënies në vonesë e deri në pagesën definitive.

Po ashtu, kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë për shkak të konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktikë duke cekse se fatura kontestuese nuk është në origjinal apo kopje e vërtetuar sipas ligjit, me propozim që Gjykata e Shkallës së Dytë, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të ndryshohet aktvendimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, KPPP.nr.570/23 të datës 26.10.2023.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e kreditorit dhe debitorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori "B & D ENGINEERING" SH.P.K., ka paraqitur propozim për përbarim, në bazë të dokumentit të besueshëm: Faturës nr. 1012/2022 të datës 23.12.2022; me të cilën është detyruar debitori që në emër të borxhit të përcaktuar sipas faturës së lartcekur, të ia paguaj kreditorit borxhin në vlerë 19,906.60 €, me kamatë ligjore prej 8 %, duke llogaritur nga data 20.11.2022 e deri në pagesën definitive si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përbarimore, me bllokimin e të gjitha llogarive bankare të debitorit, si dhe vlerësimin, shënimin, sekuestrimin e sendeve të luajtshme që janë në pronësi të debitorit, deri në realizimin e borxhit në tërësi.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar në tërësi urdhrin përbarimor, për arsye se dokumenti në bazë të cilit është marr urdhri përbarues nuk është i përshtatshëm për përbarim, duke theksuar që në faturë nuk është e cekur koha e përmbushjes së detyrimit. I ka propozuar gjykatës që të anulojë urdhrin për përbarim.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor përmes përfaqësuesit të autorizuar, ka kundërshtuar në tërësi prapësimin e debitorit duke theksuar se qëllimi i vetëm i tij është zvarritja e procedurës përbarimore, për faktin se debitori fare nuk e konteston faturën dhe borxhin që e ka ndaj kreditorit, por i njëjti e konteston vetëm faktin se nuk ceket koha e përmbushjes së detyrimit. Më tutje ka shtuar se Fatura Nr. 1012/2022 e datës 23.12.2022 është bërë e arritshme brenda 30 ditëve nga koha e pranimit të kësaj fature, gjithashtu propozimi i kreditorit është i mbështetur edhe në deklaratën për arritshmëri si dhe komunikimin përmes emailit ku kreditori i ka kërkuar debitorit përmbushjen e obligimit të rrjedhur nga fatura. Gjykatës i ka propozuar që ta refuzojë si të pabazuar prapësimin e debitorit dhe të obligohet debitori që t'i paguajë shpenzimet e përpilimit e përpilimit të përgjigjes në prapësim në shumën prej 416.00 €.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.570/23 të datës 26.10.2023, me të cilin ka vendosur si në dispozitiv të të njëjtit.

Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar gjykata ka vlerësuar se fatura në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbnim, i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm, i përmban të gjitha elementet e kërkuara dhe është i përshtatshëm për përmbnim, bazuar në dispozitat e nenit 29 par.3 dhe 37 të LPP-së. Gjykata shfuqizoi pjesërisht urdhrin përmbnimos P.nr.50/2023, të datës 24.03.2023, të Përmbnuesi Privat Driton Govori, sa i përket pjesës së obligimit të debitorit për pagesën e kamatës së përcaktuar me urdhrin përmbnimos, meqenëse në rastin konkret kamata është kërkuar prej datës 20.11.2022 e tutje, ndërsa debitori faturën e kishte pranuar me datën 28.12.2022 dhe e njëjta është bërë e arritshme pas kalimit të afatit prej 30 ditësh, andaj gjykata vlerëson se kreditori në rastin konkret nuk mund të kërkojë kamatëvonesën për një periudhë kohore në të cilën ende nuk kishte ekzistuar detyrimi i debitorit për pagesë, e aq më tepër edhe vonesa në përmbushjen e detyrimit në të holla dhe si rrjedhojë vendosi si në pikën I dhe III të dispozitivit të këtij aktvendimi duke shfuqizuar pjesërisht urdhrin sa i përket pjesës së kamatës së kërkuar.

Gjykata Komerciale – Dhomat e shkallës së dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe shkalla e dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i ankimuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbnimore kur e ka refuzuar prapësimin e debitorit, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës qartë konstatohet se përmbnimos është lejuar në bazë të faturës se lëshuar nga kreditori, e cila faturë përmban elementet që kërkohen me nenin 29 paragrafi par.3 i cili përcakton se “*Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbnim po që se ne të është treguar kreditori dhe*

debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes se detyrimit monetar”, e që në rastin konkret fatura është e pranuar nga debitori me vulë të protokulimit të debitorit.

Gjykata e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim në pajtim me dispozitat ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe gjykata e shkallës së dytë, me çka mbi bazën e këtyre rrethanave dhe fakteve kësaj gjykate i rezultoi se aktvendimi i ankimuar i nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë është i drejtë dhe i bazuar. Pas që konsideron se fatura me të cilën kreditori kërkon përmbushjen e detyrimit nga debitori, është pranuar nga debitori, fakt ky që vërtetohet nga fatura nr. 1012/2022 të datës 23.12.2022. Andaj, pranimi i së njëjtës nënkupton që debitori ka pranuar detyrimin që buron nga fatura andaj edhe konsiderohet si dokument i besueshëm.

Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë i shqyrtuan pretendimet ankimore të kreditorit, edhe sa i përket kërkesës për kamatë mirëpo erdhi në përfundim se, gjykata e shkallës së parë drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike kur ka konstatuar se debitori faturën e kishte pranuar me datën 28.12.2022 dhe e njëjta është bërë e arritshme pas kalimit të afatit prej 30 ditësh, andaj edhe kjo gjykatë vlerëson se kreditori në rastin konkret nuk mund të kërkoj kamatëvonesën për një periudhë kohore në të cilën ende nuk kishte ekzistuar detyrimi i debitorit për pagesë.

Po ashtu kjo gjykatë vlerësoj edhe pretendimet e debitori lidhur me at se fatura nuk është në origjinal por të njëjtën e refuzoj si të pa bazuar për shkak se fatura në fjalë është në origjinal ashtu sipas nenit 37 të LPP-së, pasi që fatura mban vulën e protokuluar të debitorit, andaj si e till konsiderohet se fatura është në origjinal.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e Shkallës së Dytë

K.Dh.Sh II.nr. 359/24 , datë:23.05.2024

Gjyqtarja,
Franciska Zhitija Ymeri